



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

## RAPORT GJYSMËVJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2022

### **1.Përmbledhja ekzekutive** *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Për periudhën gjashtë mujore Janar-Qershor 2022 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar 102 akte, nga të cilat 4 akte janë objekt i konsultimit publik, ndërsa aktet e tjera sipas shkronjës “c”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen këtij procesi.

4 aktet objekt i konsultimit publik janë:

1. Projektvendimi “Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2023 – 2025”.
2. Projektvendimi “Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2022-2024”.
3. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025”.
4. Projektligji “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”.

MFE ka përmbushur në masën 75% detyrimin për konsultim publik, duke realizuar konsultime publike për 3 nga 4 aktet e miratuara.

aktualisht në proces konsultimi vazhdojnë të jenë projektaktet si më poshtë vijon:

- i. “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.
- ii. “Për aministinë fiskale dhe penale të subjekteve që bëjnë deklaram vullnetar të pasurive”
- iii. “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Metodat e përzgjedhura të konsultimit janë nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, i cili përbën dhe parakushtin për konsultim publik, takimet konsultative hibride, pra online dhe me prezencë fizike, si dhe nëpërmjet emailit dhe publikimit në faqen online të ministrisë.

Sfidë mbetet rritja e cilësisë së planifikimit të akteve dhe procesit të konsultimit publik me qëllim arritjen e miratimit të akteve në kohën e parashikuar dhe duke kaluar në procedurat standard të konsultimit.

Vlerësohet se procesi, në raport me periudhën e kaluar paraqet një trend pozitiv duke shënuar rritje të frekuencës së konsultimit publik dhe të indeksit të cilësisë.

Krahasuar me vitet e shkuara, në Rregjistrin Elektronik për Konsultimet Publike ka pasur më shumë komente nga qytetarë dhe grupe interesi.

## **2. Analiza e konsultimeve të kryera**

### ***2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike***

#### ***2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?***

Akte të miratuara për periudhën 6 mujore të vitit 2022 janë 102.

#### ***2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?***

Janë konsultuar 3 akte objekt i ligjit për konsultimin publik.

1. Projektvendimi “Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2022-2024”.
2. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025”.
3. Projektligji “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”.
5. Nuk është kryer proces konsultimi publik për projektvendimin “për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2023 – 2025”.

#### ***2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?***

Vlerësimi i Ndikimit Rregullator aplikohet vetëm për 1 nga 4 aktet e miratuara:

- Projektligji “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”.

Raporti i VNR uk është hartuar për këtë akt.

#### ***2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjithshmet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?***

MFE ka parashikuar në Program Analitik miratimin e 30 akteve, ku për 23 prej të tyre aplikohen përgjithshmet e parashikuara në shkronjën “c”, të nenit 4, të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Në PKIE për vitin 2022 janë parashikuar miratimi i 8 akteve, ndërsa 3 janë aketet për të cilat janë aplikuar krieteret e përjashtimit nga konsultimi publik.

Nga 7 akte që janë parashikuar në dokumentat strategjike, për 4 prej tyre janë aplikuar kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik.

#### **2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?**

1 Projektligj dhe 2 projektvendime që miratojnë dokumenta strategjike.

#### **2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?**

Ideksi sasior dhe cilësor i KP paraqet progres krahasuar me vitin e kaluar. Priten përmirësime të mëtejshme në 6-mujorin e dytë, duke qenë se janë konsultuar disa projektakte dhe projektligje të cilat pritet ende të miratohen por që bazuar në Urdhrin nr. 3, datë 29.01.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e Udhëzuesit për Procesin e Konsultimit Publik”, në këtë raport raportohen vetëm aktet e miratuara gjatë 6 mujorit janar-qershor 2022 .

### **2.2. Metodatat e konsultimit**

#### **2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)**

Nisur nga situata e pazakontë e shkaktuar nga pandemia Covid-19, metodatat e konsultimit të aktit ishin 2, si më poshtë:

- Regjistri elektronik për njoftim dhe konsultim publik;
- Takime konsultative me grupet e interesit.
- Email dhe publikim ne faqen zyrtare të MFE

#### **2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?**

Komentet janë mbledhur nga metoda e takimeve konsultative. Publikimi në regjistrin elektronik të konsultimit publik ka qenë i frytshëm sepse ka mundur që të interesuarit të shohin aktet, por nuk ka gjeneruar numër të konsiderueshëm komentesh.

#### **2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?**

Vetë

m në 1 (një) rast. Për konsultimin e projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025”.

### **2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve**

#### **2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?**

Konsultimet publike në RENJK kanë qenë të hapura për të paktën 20 ditë pune, duke përfshirë afatin e kërkuar nga ligji. Periudha më e gjatë e konsultimit është 3 muaj për konsultimin e projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025”.

#### **2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?**

- Kohëzgjatja e konsultimit në regjistrin elektronik ka qenë 23 ditë.

#### **2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?**

Situata është përmirësuar krahasuar me vitin e kaluar. Duke krahasuar me vitet e shkuara, në Regjistrin Elektronik për Konsultimet Publike ka pasur më shumë komente nga qytetarë dhe grupe interesi, të cilat lidhen me akte që do të miratohen në periudhën e ardhshme të raportimit.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka hedhur për konsultim publik që nga viti 2017, 59 ligje.

### **2.4. Palët e interesuara të përfshira**

#### **2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?**

8 ka qënë numri i aktorëve të jashtëm, jo-qeveritarë të cilët kanë kontribuar në fazën e hershme të draftimit dhe konsultimit të projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025”.

#### **2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)**

Bazuar në urdhërin për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës janë ftuar të marrin pjesë shoqëria civile, ekspertë të jashtëm, donatorë.

**2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?**

Në konsultimin publik të të akteve kanë marrë pjesë 22 aktorë interesi dhe kanë dhënë kontribute 6 prej tyre.

**2.5 Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?**

Përfaqësues nga Dhomat e Tregtisë dhe komente me email.

**2.6 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?**

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit, pavarësisht indeksit të përmirësuar. Gjithashtu interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët për akte të caktuara.

**2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

**2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?**

4 komente janë mbledhur nga takimet konsultative.

**2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?**

3 komente u pranuan për Strategjinë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025, dhe 1 koment u refuzua për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2022-2024.

**2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?**

Krahasuar me vitet e kaluara, ku takimet publike ishin metoda që gjeneronte numrin më të madh të komenteve, kjo periudhë nuk ishte në një gjendje të kënaqshme, duke qenë se përfshirja e publikut nuk ishte në nivelin e duhur.

**2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?**

Raporti i VNR-së për “për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, nuk është hartuar dhe përditësuar

## **2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

### **2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?**

1 raport u publikua, për Strategjinë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025.

Nuk janë publikuar raportet e konsultimit publik për:

1. Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2022-2024.
2. Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore.

### **2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?**

Ndryshimet në rolin e koordinatorit të konsultimit publik.

## **2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)**

Në përfundim, bazuar në vlerësimin e cilësisë së performancës institucionale sipas metodologjisë Sigma, MFE ka performuar sipas vlerësimeve të moshtme lidhur me konsultimin publik të akteve të miratuara:

- i. Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022–2025,(8 pikë). Vlerësimi sipas metodologjisë: projektligjet publikohen në sistemin e informacionit të qeverisë, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit; janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara.*
- ii. Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike (ERP) 2022-2024, (5 pikë). Vlerësimi sipas metodologjisë: Projektligjet publikohen në sistemin informacionit të qeverisë, nuk është nxjerrë asnjë raport mbi përfshirjen e aktorëve të interesit dhe nuk janë ruajtur prova të mjaftueshme mbi reagimet e tyre.*
- iii. Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore,(3 pikë). Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit të qeverisë, por nuk ka pasur përfshirje të aktorëve të interesit.*

**3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Cilësia e performancës institucionale referuar ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik ka hapësirë për përmirësim veçanërisht në drejtimet e mëposhtme:

- Metodat e konsultimit;
- Marrja e komenteve apo sugjerimeve të ndryshme dhe reflektimi i tyre si edhe dhënia e një feedback-u në këtë kuadër;
- Planifikim më i mirë i planit vjetor nga hartuesit dhe respektimi i afateve nga ana e Drejtorive propozuese referuar këtij plani.